



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2181/ 11 prot.

Datë 10.10.2025

**V E N D I M**

**Nr. 1429/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |        |
|------------------|--------|
| Fiorent Zguro    | Anëtar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj      | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 10.10.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:**

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1325/2025, datë 24.09.2025, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-52046-06-23-2025, me objekt: “*Mbikqyrja e punimeve për 4 objekte të infrastrukturës pubike për vitin 2025*”, me fond limit: 4,671,358.41 (katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë dyzet e një) lekë pa TVSH me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2025, miratuar me VKB Nr.26, datë 03.04.2025, për një ndryshim në VKB Nr.131, Date 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025, **lotit III: REF-52058-06-23-2025**, Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10”, me fond limit: 1,248,778.49 (një milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë dyzet e nëntë ) lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “A&E Engineering” SHPK me NIPT K72113010E dhe adresë Rruga Mujo Ulqinaku, Objekti Nr.23, Z.1, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia e Tiranës me adresë Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001

## Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 24.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1325/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-52046-06-23-2025, me objekt: “Mbikqyrja e punimeve për 4 objekte të infrastrukturës pubike për vitin 2025”, me fond limit: 4,671,358.41 (katër milion e gjashëqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë dyzet e një) lekë pa TVSH me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2025, miratuar me VKB Nr.26, datë 03.04.2025, për një ndryshim në VKB Nr.131, Date 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025, **lotit III: REF-52058-06-23-2025**, Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10”, me fond limit: 1,248,778.49 (një milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë dyzet e nëntë ) lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK, duke e kualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 33159/1 prot., datë 08.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2181/8 prot., datë 09.10.2025, autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1325/2025, datë 24.09.2025, si vijon: “.....Në zbatim të vendimit nr.1325/2025 datë 24.09.2025, autooriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e ofertave sipas konstatimit dhe arsyetimit të Komisioni të Shqyrtimit të Ankesave duke kualifikuar operatorin ekonomik “A&E Engineering”

*SHPK (bashkëlidhur proces verbali i rivlerësimit datë 02.10.2025). Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj heqjen e pezullimit për procedurën e prokurimit të sipërcituar në mënyrë q të vijojmë me zhvillimin e mëtejshëm të saj”.*

*- proces verbali i rivlerësimit datë 02.10.2025 i nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave;*

## **II**

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën nr. 33159/1 prot., datë 08.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2181/8 prot., datë 09.10.2025, autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1325/2025, datë 24.09.2025, si vijon: “.....Në zbatim të vendimit nr.1325/2025 datë 24.09.2025, autooriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e ofertave sipas konstatimit dhe arsyetimit të Komisioni të Shqyrtimit të Ankesave duke kualifikuar operatorin ekonomik “A&E Engineering” SHPK (bashkëlidhur proces verbali i rivlerësimit datë 02.10.2025). Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj heqjen e pezullimit për procedurën e prokurimit të sipërcituar në mënyrë q të vijojmë me zhvillimin e mëtejshëm të saj”.

*- proces verbali i rivlerësimit datë 02.10.2025 i nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave;*

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka rivlerësuar operatorin ekonomik “A&E Engineering” SHPK në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.1325/2025, datë 08.10.2025, duke e kualifikuar këtë subjekt, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me anë të raportit të auditit si dhe të proces verbali i rivlerësimit datë 02.10.2025 i nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-52046-06-23-2025, me objekt: “Mbikqyrja e punimeve për 4 objekte të infrastrukturës pubike për vitin 2025”, me fond limit: 4,671,358.41 (katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë dyzet e një) lekë pa TVSH me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2025, miratuar me VKB Nr.26, datë 03.04.2025, për një

ndryshim ne VKB Nr.131, Date 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025, **lotit III: REF-52058-06-23-2025**, Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10”, me fond limit: 1,248,778.49 (një milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë dyzet e nëntë ) lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

